

VENDIM
Nr. 71, datë 30.11.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:
Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 1.11.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 61 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Fatjona Koçibelli

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2015-3057, datë 9.12.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 33/1, 42/2, 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksioni-min e Gjykatës Kushtetuese”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2013-4745 (427), datë 4.12.2013, ka vendosur të deklarojë fajtorë kërkuases për kryerjen e veprës penale shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, të parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal (KP), dhe në bazë të kësaj dispozite e ka dënuar atë me 4 (katër) vjet burgim.

2. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 63, datë 8.4.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 427, datë 4.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, dhe në bazë të nenit 59 të Kodit Penal ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit për pjesën e mbetur të dënimit me kusht për tre vjet, duke mbajtur kërkuasja kontakt me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Korçë.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-3057, datë 9.12.2015, mbi rekursin e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 63, datë 8.4.2014 të Gjykatës së Apelit Korçë me ndryshimin: moszbatimi i nenit 59 të KP-së, duke hequr pezullimin e ekzekutimit të dënimit.

II

4. **Kërkuesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar shfuqizimin e vendimit objekt kërkesë, pasi ai i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

4.1 Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e paanshmërisë, pasi ka bërë një vlerësim të gabuar të rrethanave të çështjes dhe provave, si dhe ka shqyrtuar çështjen në momentin kur publikisht ishte i njohur diskutimi në Kuvendin e Shqipërisë i ligjit “Për dhënie amnistie”, sipas të cilit amnistoheshin të gjitha dënimet alternative të dhëna me vendim të formës së prerë para datës 30.11.2015, sikurse ishte rasti konkret.

4.2 Gjykata e Lartë ka cenuar standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, sepse nuk ka arsyetuar lidhur me moszbatimin e dënimit alternativ të parashikuar nga neni 59 i KP-së.

4.3 Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, pasi nuk ka njoftuar kërkuesen dhe mbrojtjen e saj për seancën gjyqësore, ndërsa mbrojtësi i caktuar kryesisht nuk ka pasur mundësi të bëjë një mbrojtje efektive.

5. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, ka prapësuar me shkrim, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë vijon:

5.1 Kërkuesja nuk e ngritur në nivel kushtetues pretendimin për njëanshmëri të Gjykatës së Lartë. Fakti se kjo e fundit ka vendosur moszbatimin e nenit 59 të KP-së, duke hequr pezullimin e ekzekutimit të dënimit, nuk përbën bazë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se është shkelur ky parim.

5.2 Vendimi i kundërshtuar nuk rezulton të jetë alogjik, të ketë kundërthënie, si dhe ka respektuar të gjitha elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

5.3 Nuk është cenuar e drejta për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, sepse Gjykata e Lartë i ka marrë masat e domosdoshme për garantimin e procesit të rregullt ligjor, duke njoftuar palët me anë të shpalljes së listës së gjykimeve para godinës, si dhe nëpërmjet faqes zyrtare në internet, duke i caktuar kërkueses një mbrojtës kryesisht dhe duke mos lejuar zhvillimin e seancës në mungesë të një avokati.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

6. Kërkuesja legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

7. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkuesja *prima facie* legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e saj hyjnë në juridiksionin kushtetues. Këto pretendime janë shqyrtuar në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur në Gjykatën e Lartë.

8. Kërkuesja pretendon se Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën për t’u dëgjuar, pasi nuk e ka njoftuar atë dhe mbrojtjen e saj për seancën gjyqësore. Sipas kërkueses Gjykata e Lartë e ka shpallur datën e gjykimit të çështjes vetëm disa ditë përpara seancës gjyqësore, duke mos i dhënë mundësi asaj dhe mbrojtësit të saj të marrin dijeni për seancën, si dhe duke i caktuar një mbrojtës kryesisht. Ky i fundit nuk ka pasur mundësi të njihet në detaje me problemet juridike të çështjes, duke mos realizuar kështu një mbrojtje efektive të kërkueses.

9. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se nuk është cenuar e drejta për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, sepse Gjykata e Lartë i ka marrë masat e domosdoshme për garantimin e procesit të rregullt ligjor, duke njoftuar palët me anë të shpalljes së listës së gjykimeve para godinës, si dhe nëpërmjet faqes zyrtare në internet, duke i caktuar kërkueses një mbrojtës kryesisht dhe duke mos lejuar zhvillimin e seancës në mungesë të një avokati.

10. Gjykata ka theksuar se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe, lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit, përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishëm e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj për respektimin e këtyre parimeve, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, mes të cilave rëndësi të veçantë paraqet, sipas rastit, edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes, etj. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij. Është detyrë e shtetit që të marrë masat e duhura për të garantuar pjesëmarrjen në procesin penal të personit të akuzuar ose mbrojtësit ligjor, qoftë edhe atij të caktuar kryesisht (*shih vendimin nr. 35, datë 1.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Lidhur me të drejtën e mbrojtjes, Gjykata është shprehur se ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimin nr. 35, datë 1.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Nga ana tjetër, Gjykata ka vlerësuar se situata juridike kur rekursi paraqitet nga i akuzuari, nuk është e njëjlojtë me rastin kur rekursi paraqitet nga prokurori. Në rastet kur rekursi paraqitet nga i akuzuari, Gjykata e Lartë nuk ka ndonjë pengesë për të vazhduar shqyrtimin e çështjes edhe në mungesë të avokatit të palës së akuzuar, për shkak se argumentet ligjore ai i ka depozituar me shkrim në rekursin e paraqitur përpara saj dhe pozita e tij nuk mund të rëndohet. Ndryshe paraqitet situata kur, si rrjedhojë e një rekursi të paraqitur nga prokurori, që mbart në vetvete mundësinë e përkeqësimit të pozitës së të pandehurit, gjykimi zhvillohet pa praninë e të gjykuarit ose të avokatit të tij. Në këtë rast, nëse as avokati, as i pandehuri nuk paraqiten në seancën e Gjykatës së Lartë, është e palejueshme që ajo të vazhdojë. Prezumimi se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në gjykim me vetëdije, mund të justifikohet vetëm nëse atij i është bërë njoftimi personalisht dhe mund të vërtetohet që ai e ka marrë vetë atë. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Gjykatën e Lartë del e domosdoshme marrja e masave në mënyrë që të mos lejojë zhvillimin e seancës në mungesë të përfaqësuesit të interesave të të pandehurit, pasi kjo është e vetmja mënyrë që i pandehuri, përmes figurës përfaqësuese të avokatit, të marrë pjesë në debatet e mundshme (*shih vendimet nr. 6, datë 26.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Për sa i përket mënyrës së njoftimit të datës së seancës për gjykimin në Gjykatën e Lartë, sipas nenit 436/3 të KPP-së, sekretaria e Gjykatës së Lartë e afishon atë të paktën 10 ditë para datës së seancës.

14. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se seanca e parë gjyqësore në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në datën 18.11.2015. Nga *website* i Gjykatës së Lartë, Gjykata konstaton se në listën e çështjeve penale për gjykim në këtë datë, nuk rezulton emri i kërkuar. Nga ana tjetër, kjo listë është shpallur në 11.11.2015, duke mos respektuar afatin 10-ditor i përcaktuar nga neni 436/3 i KPP-së. Në këtë seancë nuk kanë qenë të pranishëm as kërkuarja, as mbrojtësi i zgjedhur prej saj. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka caktuar kërkuarja mbrojtës kryesisht dhe e ka shtyrë seancën për në datën 2.12.2015. Edhe kjo seancë është shtyrë për shkak të mungesës së justifikuar të mbrojtësit të caktuar kryesisht. Lista e seancës së radhës, e datës 9.12.2015, është shpallur në datën 2.12.2015, përsëri duke mos u respektuar afati 10-ditor. Në këtë seancë kërkuarja është mbrojtur nga avokat i caktuar kryesisht, i cili ka depozituar edhe memorie.

15. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se edhe pse kërkuarja i është caktuar mbrojtës kryesisht, Gjykata e Lartë jo vetëm nuk e ka njoftuar kërkuarjen për datën e seancës, duke mos respektuar

dispozitën për shpalljen e listës së gjykit dhe të afateve përkatëse, por në mungesë të paraqitjes së mbrojtësit të caktuar prej saj në gjykim, nuk i ka marrë të gjitha masat për t'i dhënë kërkukses mundësinë për të pasur një mbrojtje reale dhe efektive. Për pasojë, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkukses është i bazuar.

C. Për pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë

16. Kërkuessa pretendon se Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e paanshmërisë, pasi ka bërë një vlerësim të gabuar të rrethanave të çështjes dhe provave si dhe ka shqyrtuar çështjen në momentin kur publikisht ishte i njohur diskutimi në Kuvendin e Shqipërisë i ligjit “Për dhënie amnistie”, sipas të cilit amnistoheshin të gjitha dënimet alternative të dhëna me vendim të formës së prerë para datës 30.11.2015, sikurse ishte rasti konkret.

17. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se kërkuessa nuk e ka ngritur në nivel kushtetues pretendimin për njëanshmëri të Gjykatës së Lartë. Fakti se kjo e fundit ka vendosur moszbatimin e nenit 59 të KP-së, duke hequr pezullimin e ekzekutimit të dënimit, nuk përbën bazë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se është shkelur ky parim.

18. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme ka rëndësi. Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimin nr. 11, datë 3.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Jurisprudenca e Gjykatës ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykit. Për Gjykatën është konsideruar gjykatë e njëanshme trupi gjykues që nuk jep garancitë e nevojshme për një gjykim të paanshëm në këndvështrimin objektiv. Dyshimi i mundshëm për paanshmërinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimin nr. 11, datë 3.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nga ana tjetër, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar në mënyrë të vazhdueshme se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Gjykata ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësim të fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të ndryshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015 të*

Gjykatës Kushtetuese).

21. Bazuar në këto standarde, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuases se Gjykata e Lartë ka bërë një vlerësim të gabuar të rrethanave të çështjes dhe provave, si dhe ka shqyrtuar çështjen në momentin kur publikisht ishte i njohur diskutimi në Kuvend i ligjit “Për dhënie amnistie”, nuk lidhen me parimin e paanshmërisë së saj. Gjykata çmon se këto pretendime në thelb kanë të bëjnë me çmuarjen nga ana e gjykatës të provave, si dhe me bindjen e saj të brendshme në lidhje me deklarinimin ose jo fajtores të kërkuases. Si e tillë, kjo çështje i takon sferës së kompetencës së gjykatave të zakonshme, të cilat bëjnë vlerësimin juridik të rrethanave dhe provave të parashtruara nga palët, dhe jo juridiksionit kushtetues. Ky i fundit nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor, aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Qëndrimi i mbajtur në jurisprudencën e kësaj Gjykate është se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, përderisa pretendimet e kërkuarit nuk lidhen me cenimin e ndonjë standardi kushtetues.

22. Nga sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuases për cenimin e parimit të paanshmërisë është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit

23. Sipas kërkuases, Gjykata e Lartë ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, sepse nuk ka arsyetuar lidhur me moszbatimin e dënimit alternativ të parashikuar nga neni 59 i KP-së. Lidhur me këtë pretendim, subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se vendimi i kundërshtuar nuk rezulton të jetë alogjik, të ketë kundërtënie, si dhe ka respektuar të gjitha elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

24. Gjykata ka theksuar tashmë se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjyqimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërtënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin në shqyrtim Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka analizuar

kërkesat e palëve dhe ligjin e zbatueshëm, duke përmbushur elementet e përcaktuara nga jurisprudenca e kësaj Gjykate për respektimin e standardit të arsytimit të vendimit. I vetmi shkak i paraqitur nga kërkuesja është ai lidhur me zbatimin ose jo të nenit 59 të KP-së dhe gjithë arsytimi i Gjykatës së Lartë (shih faqet 8-11 të vendimit të Gjykatës së Lartë) lidhet me këtë shkak. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsytimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadër të përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit, sikurse pretendon edhe kërkuesi në rastin konkret. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsytimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Për pasojë, Gjykata çmon se edhe ky pretendim i kërkueses është i pabazuar.

28. Si përfundim, Gjykata çmon se në rastin konkret Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka cenuar kërkueses të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në gjykim, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkueses është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
 - Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-3057, datë 9.12.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
 - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Vladimir Kristo, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuese Fatjona Koçibelli jemi kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-3057, datë 9.12.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë.

2. Kërkuesja ka pretenduar se i është cenuar e drejta për t'u dëgjuar në Gjykatën e Lartë për arsye se ajo dhe mbrojtësi i saj nuk janë njoftuar për seancën gjyqësore. Sipas kërkueses, Gjykata e Lartë e ka shpallur datën e gjykimit të çështjes vetëm disa ditë përpara seancës gjyqësore, duke mos i dhënë mundësi asaj dhe mbrojtësit që të marrin dijeni për seancën, si dhe duke i caktuar një mbrojtës kryesisht, i cili nuk ka pasur mundësi të njihet me çështjen duke mos realizuar një mbrojtje efektive.

3. Në lidhje me standardet e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në gjykim, Gjykata ka theksuar se e drejta e mbrojtjes duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të

gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve. Veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj për respektimin e këtyre parimeve, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, mes të cilave rëndësi të veçantë paraqet, sipas rastit, edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes, etj. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij. Është detyrë e shtetit të marrë masat e duhura për të garantuar pjesëmarrjen në procesin penal të personit të akuzuar ose mbrojtësit ligjor, qoftë edhe atij të caktuar kryesisht (*shih vendimin nr. 6, datë 26.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë është vlerësuar se situata juridike kur rekursi paraqitet nga i akuzuari, nuk është e njëjlojtë me rastin kur rekursi paraqitet nga prokurori. Prania personale e të pandehurit në seancën gjyqësore për shqyrtimin e ankimit të paraqitur nga mbrojtësi i tij nuk është e domosdoshme, nëse objekt shqyrtimi janë trajtimet dhe përfundimet juridike të arritura nga gjykata më e ulët, vendimi i së cilës nuk mund të ndryshohet në disfavor të të pandehurit. Në këto raste, Gjukata e Lartë nuk ka ndonjë pengesë për të vazhduar shqyrtimin e çështjes edhe në mungesë të avokatit të palës së akuzuar, për shkak se argumentet ligjore ai i ka depozituar me shkrim në rekursin e paraqitur përpara saj. Ndryshe paraqitet situata kur si rrjedhojë e një rekursi të paraqitur nga prokurori, që mbart mundësinë e përkeqësimit të pozitës së të pandehurit, gjykimi zhvillohet pa praninë e të gjykuarit ose të avokatit të tij. Në rast se as avokati, as i pandehuri nuk paraqiten në seancë në Gjykatën e Lartë është e palejueshme që ajo të vazhdojë. Prezumimi se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në gjykim me vetëdije mund të justifikohet vetëm nëse atij i është bërë njoftimi personalisht dhe mund të vërtetohet që ai e ka marrë vetë atë. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Gjykatën e Lartë del e domosdoshme marrja e masave në mënyrë që të mos lejojë zhvillimin e seancës në mungesë të përfaqësuesit të interesave të të pandehurit, pasi kjo është e vetmja mënyrë që i pandehuri, përmes figurës përfaqësuese të avokatit, të marrë pjesë në debatet e mundshme (*shih vendimin nr. 6, datë 26.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Gjukata ka theksuar, gjithashtu, se personi që ushtron ankim/rekurs është i interesuar të ndjekë fatin e ankimit të tij, por kjo nuk nënkupton se i takon vetëm atij përgjegjësia të ndjekë pafundësisht fatin e dosjes gjyqësore, e cila administrohet nga gjykata dhe jo nga kërkuesi. Po në këtë drejtim, Gjukata është shprehur se është detyrë e administratës gjyqësore të njoftojë ankuesin/rekursuesin kur dokumentacioni që shoqëron ankimin/rekursin është i paplotë. Ajo ka theksuar se e drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë nuk mund t'i cenohen kërkuesit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore (*shih vendimin nr. 32, datë 22.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Në rastin në shqyrtim, sipas shumicës, gjen zbatim neni 436/3 i KPP-së, sipas të cilit sekretaria e Gjykatës së Lartë e afishon datën e seancës për gjykim të paktën 10 ditë para zhvillimit të saj. Seanca e parë gjyqësore në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në datën 18.11.2015 dhe nga *website* i Gjykatës së Lartë rezulton se në listën e çështjeve penale për gjykim në këtë datë nuk ndodhet emri i kërkueses. Nga ana tjetër, kjo listë është shpallur në datën 11.11.2015, duke mos u respektuar afati 10-ditor i përcaktuar nga neni 436/3 i KPP-së. Në këtë seancë nuk kanë qenë të pranishëm as kërkuesja, as mbrojtësi i zgjedhur prej saj dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka caktuar kërkueses mbrojtës kryesisht, duke e shtyrë seancën për në datën 2.12.2015, por edhe kjo seancë është shtyrë për shkak të mungesës së justifikuar të mbrojtësit të caktuar kryesisht. Lista e seancës së radhës, e

datës 9.12.2015, është shpallur në datën 2.12.2015, përsëri duke mos u respektuar afati 10-ditor. Në këtë seancë kërkuessa është mbrojtur nga avokat i caktuar kryesisht, i cili ka depozituar edhe memorie (*shih paragrafin 14 të vendimit*). Nisur nga këto rrethana shumica ka vlerësuar se edhe pse kërkuessa i është caktuar mbrojtës kryesisht, Gjykata e Lartë jo vetëm nuk e ka njoftuar kërkuessen për datën e seancës, duke mos respektuar dispozitën për shpalljen e listës së gjyqimit dhe të afateve përkatëse, por në mungesë të paraqitjes së mbrojtësit të caktuar prej saj në gjykim, nuk i ka marrë të gjitha masat për t'i dhënë kërkuesses mundësinë për të pasur një mbrojtje reale dhe efektive (*shih paragrafin 15 të vendimit*).

7. Ne gjyqtarët në pakicë, në ndryshim nga përfundimi i arritur nga shumica, vlerësojmë se pavarësisht se për seancën e parë gjyqësore nuk është bërë shpallja në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, nuk është arritur të provohet se nuk është përmbushur detyrimi për afishimin e datës së seancës në këndin përkatës të njoftimeve në atë gjykatë, edhe pse i takonte kërkuesses barra e provës për të provuar këtë pretendim të saj. Megjithatë, pavarësisht këtij fakti, Kolegji Penal, pasi ka konstatuar mungesën e kërkuesses dhe të mbrojtësit të saj, ka vendosur t'i caktojë asaj mbrojtës kryesisht dhe e ka shtyrë seancën për në datën 2.12.2015, e cila është shtyrë më pas për në datën 9.12.2015 për shkak të mungesës së mbrojtësit të caktuar kryesisht. Për këto seanca gjyqësore Gjykata e Lartë ka proceduar edhe me shpalljen publike, fakt që pranohet nga shumica në vendimin e saj.

8. Gjykata ka vlerësuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin kushtetues dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit. Duke shkuar më tej, Gjykata nuk ka pranuar pretendimet për cenimin e parimeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë ka plotësuar apo korrigjuar mangësitë e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 9, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Bazuar në faktet e çështjes konkrete dhe standardet e mësipërme, ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se Gjykata e Lartë ka respektuar dispozitat procedurale për njoftimin e palëve dhe nuk ka cenuar të drejtën e kërkuesses për një proces të rregullt ligjor. Ajo ka marrë masat për njoftimin e palëve dhe i ka garantuar kërkuesses të drejtën e mbrojtjes nëpërmjet mbrojtësit të caktuar kryesisht, i cili ka marrë pjesë në gjykim, ku i është dhënë mundësia që të dëgjohet dhe të paraqesë argumentet e tij në kundërshtim të pretendimeve të palës tjetër në proces.

10. Në lidhje me argumentin e shumicës se Gjykata e Lartë nuk ka respektuar kërkesat e nenit 436/3 të KPP-së në lidhje me seancën e datës 9.12.2015, pasi shpallja është bërë në datën 2.12.2015, duke mos u respektuar afati 10-ditor, vlerësojmë se shumica mban një qëndrim të gabuar në lidhje me mënyrën e interpretimit të kësaj dispozite. Në interpretim të pikës 3 të nenit 436 të KPP-së rezulton se afati ligjor 10-ditor lidhet me njoftimin e palëve për seancën e parë gjyqësore që do të zhvillohet në Gjykatën e Lartë, por nuk nënkupton që ky afat zbatohet për të gjitha seancat e mëpasshme, kalendari i të cilave përcaktohet në varësi të volumit të çështjeve për shqyrtim në Kolegji. Gjithsesi, në vlerësimin tonë, mosrespektimi i këtij afati ligjor nuk mund të konsiderohet si shkelje kushtetuese, për sa kohë që Gjykata e Lartë gjatë shqyrtimit të çështjes u njeh palëve dhe u garanton të drejtat e tyre kushtetuese. Ajo çfarë vihet re gjithashtu në rastin në fjalë është se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka rënduar pozitën e kërkuesses, për sa kohë që ka lënë në fuqi vendimet gjyqësore të gjykatave të faktit, me ndryshimin e moszbatimit të nenit 59 të KP-së, duke hequr pezullimin e ekzekutimit të vendimit.

11. Për sa më sipër, ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se edhe pretendimi i kërkuesses për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar në Gjykatën e Lartë është i pabazuar, për rrjedhojë Gjykata duhej të vendoste rrëzimin e kërkesës.

Anëtarë: Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj